

PROBLEMET ME ABUZIMIN E DROGES



Kush e perdor drogen?
Ku dhe Kur?
Sa shume?
Perse e perdorin?

PERSE JANE KETO PYETJE TE
RENDESISHME?



ÇFARË ËSHTË DROGA?

- Droga është një substancë që sjell ndryshime fizike dhe psikologjike dhe mund të jetë e ngurtë, e lëngshme.
- Drogat më shqetësuese janë drogat psikoaktive sepse ato veprojnë mbi trurin dhe ndryshojnë mënyrën se si mendon, sillet dhe ndjehet individi.
- Ka tre lloje kryesore droge:
 - depresantët,
 - stimuluesit dhe
 - haluçinogjenët.



- Drogat depresuese nuk shkaktojnë gjithnjë depresion tek përdoruesi por, ato ndikojnë tek përqëndrimi, koordinimi dhe ngadalësojnë aftësinë për t'ju përgjigjur situatave të papritura.
- Personat që marrin haluçinogjenë mund të shohin apo të dëgjojnë gjëra që nuk ekzistojnë, ose mund të shohin gjëra të tjetërsuara rreth vetes.
- Drogat stimuluese shpejtojnë veprimtarinë e trurit si rrjedhim personi që merr stimulantin ndjehet më i gjallë, i vëmendshëm dhe i sigurt tek vetja.



KUSH E PERDOR DROGEN?

- Mosha ku drogerat perdoren me shume.
- Mardheniet qe kemi (shoke/shoqe, prinder, i/e dashur, te njohur etj.)
- Cfare profesioni kane (student, mesues, biznesmen, te papune)

Ku dhe Kur e perdorin?

- Situata ne te cilen nje droge meret ka nje impakt shume te madhe.

Shembull: Nje drejtore kompanie pi mariuane te shtunen ne mbremje ne shtepin e tij ose ky drejtor pi mariuane ne takim pune me disa kliente te tij.



SI NDIKON DROGA TEK NJË PERSON?

- Efektet e një droge të caktuar varen nga një numër faktorësh.
 - Lloji i drogës që është marrë
 - Sa drogë merret dhe sa shpesh merret ajo
 - Si merret droga
 - Karakteristikat fizike
 - Humori dhe mjedisi i përdoruesit
 - Llojet e drogave të tjera që përdoren



CILAT JANË 5 KATEGORITË E PËRDORIMIT TË DROGËS?

- **Përdorimi eksperimental** ku personi e provon drogën një apo dy herë sepse është kureshtar.
- **Përdorim argëtues** ku personi vendos të marrë drogë për kënaqësi, për të shijuar më shumë një gjendje emocionale apo një rast social.
- **Përdorim situate** ku personi e përdor drogën gjatë një situate të caktuar.
- **Përdorim intensive** ku personi përdor sasi të mëdha droge gjatë një periudhe të shkurtër
- **Përdorim i varur** ku personi bëhet i varur nga droga pas një përdorimi të gjatë ose të rëndë me kalimin e kohës.



SI NDIKON DROGA TEK INDIVIDID?

- Probleme me shkollën ose punën
- Përjashtimi nga shkolla
- Aksidentet
- Probleme me shkeljen e ligjit
- Probleme financiare
- Probleme shëndetësore
- Probleme seksuale
- Ndikimi në familje
 - Marrëdhëniet familjare dhe martesore
 - Ndikimi tek anëtarët më të vegjël të familjes



SA SHUME?

- Kjo eshte diferenca midis perdorimit normal te nje droge dhe abuzimit; midis jetes dhe vdekjes.

Perse e perdorin?

- Nje person behet perdorues droge per te kuruar nje semundje kronike ose dhimbje kronike.

Shembull: Nje person perdor Vikodinen per te ulur nivelin e dhimbjeve kronike qe ndien ne trup (thyerja e kembes), ose ne rast te kundert, nje person mund te perdori vikonidinen per shkak te nivelit te kenaqesis qe shkakton.

4 PARIMET E DROGES

- “Droga” nuk eshte e mire apo e keqe
- Cdo droge ka efekte te shumefishta
- Sasia dhe kualiteti i droges ndikojne ne efektin e droges
- Efekti i droges varet nga personi



FAKTORE TE RENDESHISEM QE COJNE NE EXSPERIMENTIMIN E PERDORIMIN E DROGERAVE.

- marrëdhëniet e dobëta prind-fëmijë;
- çrregullimet psiqike, sidomos depresioni;
- tendenca për të kërkuar eksperiencia të reja apo të ndërmarrë rreziqe;
- anëtarët e familjes dhe shokët që përdorin substanca;
- motivimi i ulët akademik;
- mos besimi fetar;
- përdorimi i hershëm i cigares;
- mos vet-vlerësimi;
- rritja në një familje me një prind ose të përzier;
- angazhimi në sjellje shëndet-cënuese.



SHENJA PARALAJMËRUESE FIZIKE TË ABUZIMIT TË DROGËS

- Sytë hiperhemik(të skuqur), pupilat midriatike ose miotike (më të mëdha ose më të vogla se zakonisht).
- Ndryshimet në oreks apo në modelet e gjumit. Humbje e papritur peshe apo shtim në peshë.
- Përkeqësimi i pamjes fizike, dhe ndryshim i zakoneve personale.
- Erë të pazakonshme të frymës, të trupit dhe veshjes.
- Të dridhura, marrje e gojës, dobësim i koordinimit të veprimeve.



SHENJA PARALAJMËRUESE SJELLORE TË PËRDORIMIT TË DROGËS

- Rënie në mësim.
- Humbje parash apo objektesh të çmuara në shtëpinë e nxënësit të dyshuar.
- Devijime sjellore.
- Ndryshim i papritur i shoqërisë, dhe preferencave shoqerore.
- I predispozuar për zënie, për aksidente dhe veprimtari të paligjshme.



SHENJAT PARALAJMËRUESE PSIKOLOGJIKE TË ABUZIMIT ME DROGËN

- Ndryshim i paspjegueshëm në personalitet ose qëndrim.
- Luhatje të papritura të humorit, nervozizëm, apo shpërthime zëmërimi.
- Periudha mbiakiviteti të pazakontë, axhitim, ose marramendje.
- Mungesa e motivimit, përgjumje ose ç'përqëndrim
- Pa arësye shfaq frikë, ankth, ose paranojë.



Metodad E Marjes se Drogas

Orale

Inhalacion

Aplikim
ne Lekure

Injeksion



KLASIFIKIMET E NDRYSHME TE DROGERAVE

- Narkotiket
- Stimulantet
- Depresantet
- Kanabis
- Halucinogenet
- Inhalantet



NARKOTIKET

- Tek drogerat narkotike bejne pjese: Heroina, Morfina, etj.
 - Perdoren per te “M’pire” shqisat e ulur nivelin e dhimbjeve.
 - Drogerat narkotike prodhohen nga Opiumi ose ne laboratore me perdorimin e narkotikeve sintetik.
 - Shenjat paralajmeruese te droges: Miozë; mosreagim i pupilave në dritë; shenja injektimesh; fjetje në kohë të pazakontë; djersitje; të vjella; kollitje; gërhitje; tremor; humbje e oreksit.
 - Efektet e overdozes: Frymarje e ngadalte, lekure e lageshte, spazma, koma e gjithashtu mund te rezultoj ne vdekje.
 - Pseudonimet: Horse & Black Tar (Heroine), White Lady & Miss Emma (Morfine).
- 

STIMULANTET

- Tek stimulantet bejne pjese: Kokaina, Amfetamina, Metamfetamina, etj
- Stimulantet ndryshojne efektet e lodhjen ne truping a trurin e njeriut.
- Shenjat paralajmeruese te droges:Midriazë; hiperaktivitet; eufori; nervozizëm; ankth; logore e ndjekur nga depresioni ose fjetje e tepruar në kohë të papërshtatshme; mund të shkojë një kohë e gjatë pa ngrënë apo fjetur; humbje peshe; goja dhe hunda e thatë.
- Efektet e overdozes: Agjitacion, temperature e larte,halucinacione, spazem, mund te rezultoj ne vdekje.
- Pseudonimet: Snow & Crack (Kokaina), Ice, Meth & Tina (Metamfetamine)



DEPRESANTET

- Tek depresantet bejne pjese: Sedativet, Qetesuesit, Hipnotiket ose gjumevenesit, medikamente anti-ankth gjithashtu dhe alkoli.
- Depresantet perdoren per te trajtuar ankthin, ataket e panikut, epilepsin, spazma muskulare dhe sindromin e terheqjes nga alkoli.
- Shenjat paralajmeruese te droges: Pupila miotike; pamje të dehuri; vështirësi përqëndrimi; ngathtësi; gjykim të dobët; e folur e penguar; përgjumje.
- Efektet e overdozes: Perdorimi i nje sasive te madhe depresantesh, ose perdorimi i depresanteve me alkohol mund te rezultoj ne vdekje.
- Pseudonimet: Nuk ekzistojne.



KANABIS

- Marijuana dhe hashish jane substanca te referuara si Kanabis.
- TCH (delta-9-tetrahydrocannabinol) eshte ingredienti kryesor ne kanabis qe na ben “Dru” ose “High”.
- Perdoret me lejen nga mjeku per pacientet me kancer per te parandaluar te vjellat dhe nga te semuret me HIV per te hapur oreksin.
- Shenjat paralajmeruese te droges: Sy të qelqtë e të skuqur; e folur me zë të lartë; qeshje pa vend pasuar nga përgjumje; humbja të interesit, e motivimit; fitim ose humbje në peshë.
- Efektet e overdozes: Lodhje, paranoje, psikoze.
- Pseudonimi: Dope, Pot, Aunt Mary.



HALUCINOGENET

- Tek Halucinogenet bejne pjese: LSD, Ekstazi, PCP, Ketamina, Peyote dhe Mescaline.
- LSD, Ekstazi, PCP & Ketamina prodhohen ne laboratore.
- Peyote dhe Mescalina prodhohen nga nje kaktus I quajtur Peyote qe gjended ne Meksike.
- Keto substanca ndryshojne perceptimin e sjelljen e perdoruesve.
- Shenjat paralajmeruese te droges: Midriazë; sjellje të çuditshme dhe të paarsyeshme, duke përfshirë paranojë agresion, haluçinacione, gjendje shpirtërore e luhatëshme; shkëputje nga njerëzit; e folur e penguar; konfuzion.
- Efektet e overdozes: Temperatur e larte, arrest kardiak, spazma, marrje fryme, koma e ne disa raste vdekje.
- Pseudonimet: Angel Dust (PCP), Love drug (Ekstazi), Acid (LSD), Special K (Ketamina).



INHALANTET

- Disa sende si ngjitesi i lengshem, boje muresh, leng mbushes cakmaku, produkte pastrimi, boje kepucesh, etj, permbajne kimikate qe prodhojne efekte dehese te ngjashme me alkolin.
- Abuzimi me inhalantet ndodh duke nuhatur kimikatet.
- Shenjat paralajmeruese te droges: Sy të përlotur; probleme me shikimin, kujtesën dhe mendimit; sekrecione nga hunda apo puçra rreth hundës dhe gojës; dhimbje koke dhe të përzier; pamja të dehuri; përgjumje; kontroll i dobët i muskujve; ndryshime në oreks; ankth; nervozizëm.
- Efektet e overdozes: Demtime ne zemer, mushkri, veshka, melci dhe tru; mund te shkaktoj vdekje me nje perdorim te vetem ose mbas disa perdorimesh.
- Pseudonimet: Rush & Kick.



MJEKIMI I MBIDOZES

- *Perbehet nga Trajtimi I pergjithshem e ai specifik*
- *Trajtimi i përgjithshëm* mund të konsistojë në:
 - lavazh të stomakut dhe dhënjën e *karbonit aktiv* të pasuar nga një *preparat laksativ* (në rast se substanca është marrë per os);
 - oksigjenim;
 - mbështetje psikologjike, e cila mund të shoqërojë procesin e ndihmes së parë.
- *Trajtimi specifik :*
 - organizohet ne baze te substancës apo llojit të substancës të mbidozuar (kjo lehtësohet kur kapaciteti profesional e mundëson specifikimin).



SINDROMI I TERHEQJES

○ Simptomat e sindromit të tërheqjes

Kushdo që bëhet i varur nga droga është I predispozuar të vuajë simptomat e tërheqjes në kushte provokuese për të.

- Simptomat e tërheqjes ndodhin kur trupi dhe truri reagojnë negativisht nga mungesa e një droge të caktuar në sistem.
- Trupi ambientohet me substancën psikoaktive, kështu që kur ajo nuk është më e pranishme, ndodhin reagime negative (simptomat e tërheqjes).
- Simptomat e tërheqjes ndodhin nga: varësia e kokainës, heroinës, metamfetaminës, marijuanës, si dhe substancave të tjera psikoaktive (varësi dhënëse).



SINDROMI I TERHEQJES

- **Kush vuan nga simptomat e tërheqjes?**
- Çdo individ i cili ka krijuar varësi ndaj drogave mund të bie viktimë e simptomave të tërheqjes.
- Këto simptoma shfaqen si gjatë një programi detoksifikimi të mbikëqyrur (kur individ i ka bërë zgjedhjen e ndërgjegjshme për tu trajtuar ndaj varësisë) ose në mes të një varësije, kur individ është në kërkim të dozës së tij të ardhshme të drogës së varësisë.
- Simptomat e tërheqjes ndodhin në të dy sekset, si dhe pa dallim moshe.
- Graviteti i simptomave të tërheqjes varet nga gjendja mendore e individëve drogë-varur, gjendja e tyre fizike dhe faktorët gjenetik. Për këto arsye, trajtimi mjekësor i tërheqjes është shumë individual.



SINDROMI I TERHEQJES

- Cilat janë simptomat më të zakonshme të sindromit të tërheqjes?
- Simptomat e tërheqjes shfaqen në dy forma ,ato emocionale dhe fizike.
- *Simptomat emocionale*: periudha të zgjatura të depresionit; ankth; nervozizëm; paqëndrueshmëri në humor; mendime për vetëvrasje.
- *Simptome fizike*: të përziera e të vjella; djersitje; shtrëngime dhe dhimbje të muskujve; pagjumësi; ethe; rrjedhje hundësh.



SINDROMI I TERHEQJES

- **Sa mund të zgjasin simptomat e tërheqjes?**
- Zgjatja e sindromit të tërheqjes varet nga vet dipendenti, nga lloji i substancës së varësisë, nga doza e saj, frekuenca, koha e përdorimit dhe sigurisht nga ndërhyrja trajtuese.
- Efektet kryesore fizike të tërheqjes, të tilla si dhimbje, djersitje, të dridhura, të vjella, diarre, të përziera, etj, zakonisht zgjasin rreth 5 ditë.
- Pjesa tjetër, tërheqja afat - gjatë apo PAWS (sindroma post akute e tërheqjes) mund të zgjasë nga disa javë deri në disa vjet.
- Është pikërisht periudha post akute, e shoqëruar me simptoma shqetësuese si tension nervor, ankth, pagjumësi, halucinacione, depresion, etj, ajo që shpesh mund të bëhet shkak i relapseve (rikthimit tek droga).



SINDROMI I TERHEQJES

- **Sa serioze janë simptomat e tërheqjes?**
- Sindromi i tërheqjes mund të variojë nga i lehtë e i mesëm shoqëruar me simptomatikë relativisht të lehtë, deri në atë të rëndë me simptomatikë kërcënuese për jetën, si konvulsione epileptike, atak i zëmrës, ishemi cerebrale, halucinacione, kolaps, etj.
- Një detoksifikim mjeksor i mbikëqyrur mund të minimizoj simptomet e tërheqjes dhe të reduktojë rrezikun e komplikimeve të rrezikshme.



ABUZIMI/ KEQPERDORIMI I SUBSTANCAVE

- Abuzimi i substancave definohet si përdorimi problematik por jo kompulsiv(detyrues) i tyre, pa tolerancë të rëndësishme, ose pa sindrom të tërheqjes.
- Përgjithësisht shërbimet trajtuese të abuzimit të substancave përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:
 - Informacion mbi drogën në shkollë
 - Trajtim ambulator



VAREsia nga SUBSTANCAT

- Varësia nga substancat definohet si një sindrom që përfshin përdorimin kompulsiv të substancave, tolerancën dhe tërheqjen.
- Diagnoza e varësisë nga substancat përcaktohet në rast të përjetimit nga individ i tre ose më shumë nga situatat e mëposhtme, brenda një periudhe 12-mujore:
- Toleranca,
- Tërheqja
- Përpjekje të pasuksesshme për të ndërprerë përdorimin e substancës
- Shpenzim i një kohe të ndjeshme për sigurimin dhe përdorimin e substancës
- Kufizimi apo largimi nga aktivitetet e ndryshme shkollore apo jasht shkollore për shkak të përdorimit të substancave
- Vazhdimi i përdorimit të substancave përkundër njohjes së problemit.



PASTRAJTIMI (AFTERCARE)

- ***Pastrajtimi (aftercare)***

Qëllimi i pastrajtimit është të mbështesë abstinencën e individit, e arritur falë respektimit të një cikli të përshtatshëm trajtues adiktiv, kryesisht duke i krijuar atij kushte mbështetëse sociale e institucionale, parandaluese të relapsit.



ANGAZHIMI I KOMUNITET NE PROBLEMET E DROGES NE SHKOLLE

○ **Studentët:**

- Duhet të bëhen zgjidhës të problemit dhe që në mënyrë aktive të kërkojnë mënyra për të qenë pjesë e përpjekjeve për parandalim e drogës në shkolla dhe komunitete.
- Duhet të marrin pjesë në projekte të shërbimit të komunitar.

○ **Mësuesit , OSH dhe Administratorët :**

- Duhet të përfshihen në organizatat e komunitetit dhe në aktivitetet e tyre.
- Të bashkëpunojnë me komunitetin për mbështetje të përpjekjeve të shkollës për parandalimin e përdorimit të drogës, duke krijuar ekipe shkollë-komunitet.
- Të risin kulturën mbi ATOD, që prekin studentët dhe komunitetit përreth.



ANGAZHIMI I KOMUNITET NE PROBLEMET E DROGES NE SHKOLLE

○ Ekipet Shkollë-komunitet:

- Duhet të implementojnë strategji parandaluese, si pjesë e ciklit të përmirësimit të shkollës.
- Të njohin dhe të kontaktojnë me agjencitë e komunitetit dhe të komunikojnë pozitivisht për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet parandaluese.
- Të zhvillojnë strategji që motivojnë njerëzit në komunitetin përreth për tu përfshirë aktivisht në programet parandaluese të shkollës.



VAZHDIM

- **Prindërit dhe anëtarët e komunitetit:**
 - Duhet të kuptojnë dhe mbështesin parimevet e parandalimit të ATOD.
 - Duhet të kenë dijeni rreth kurrikulave shkollore për parandalimin e ATOD në shkolla lokale.
 - Duhet të përfshihen në proceset e rishikimit dhe planifikimit të këtyre kurrikulave dhe planifikimin në shkollat.
 - Të nxisin modelet drug-free në shkolla dhe komunitet.
 - Të ketë vullnetarë për të udhëzuar nxënësit që janë në rrezik për përdorim ATOD.



ANGAZHIMI I KOMUNITET NE PROBLEMET E DROGES NE SHKOLLE

- **Organizatat e komunitetit dhe Agjencitë:**
 - Të bashkëpunojnë midis tyre dhe me shkollat për të nxitur parandalimin.
 - Të fokusojnë më shumë përpjekje ndaj popullsisë "së vështirë për tu arritur" duke zhvilluar metoda efikase për përfshirjen e tyre.



REFERENCA

- <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescents-health-risks-and-solutions>
- <https://nida.nih.gov/research-topics/prevention#evidence-based-prevention-strategies>
- <https://my.clevelandclinic.org/health/articles/addictive-substances>
- <https://www.healthychildren.org/English/ages-stages/teen/substance-abuse>



Fund

